



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 767/2 Prot.

Tiranë, më 28.10.2021

V E N D I M

Nr.135, datë 28.10.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë në procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Specialist Projektesh dhe Rregjistrin Elektronik”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat.

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Specialist Projektesh dhe Rregjistrin Elektronik”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat, të paraqitur nga nëpunësi
*****.

Vërej se:

Konkurenti ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 767 prot., datë 19.08.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Specialist Projektesh dhe Rregjistrin Elektronik”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat, të cilat sipas tij, kanë ndikuar në rezultatet e konkurrimit e për rrjedhojë përcaktimin e fituesit.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u kërkua dokumentacioni sqarues nga Bashkia Berat. Ky dokumentacion është dërguar me dy e-mail, të datave 14.09.2021 dhe 29.9.2021, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar si më poshtë:

Nëpunësi ***** ka qenë nëpunës civil, në pozicionin e punës “*Specialist i Kontrollit të Investimeve të Punëve Publike dhe Private*”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në Bashkinë Berat, (*akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil nr. 69 prot., datë 07.01.2021*), por me aktin nr. 275/4, datë 18.02.2021, “*Për lirimin nga shërbimi civil*”, të Kryetarit të Bashkisë Berat, është liruar nga kjo detyrë për shkak të shkurtimit të vendit të tij të punës dhe pamundësisë për tu sistemuar në një pozicion tjetër, për të cilin ai plotësonte kushtet.

Nisur nga përmbajtja e pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit, punonjësit të cilët lirohen apo janë liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, krahas të drejtës së dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, gëzojnë gjithashtu dhe drejtën për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe të drejtat për t`u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Bazuar në të drejtën e mësipërme, nëpunësi ***** pas është njohur me njoftimin që Bashkia Berat, ka bërë në datën 29.06.2021, në faqen online, të “*Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive*”, për shpalljen e pozicionit të lirë të punës “*Specialist Projektsh dhe Rregjistrat Elektronik*”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat, në dt. 09.07.2021, ka aplikuar për pjesëmarrje nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Berat, i ka dërguar konkurrentit, në rrugë elektronike, njoftimin me përmbajtjen e mëposhtme:

“*...Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Berat, në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, ju njofton se nuk jeni kualifikuar për të vazhduar fazat e mëtejshme të konkurimit për pozicionin e mësipërm, për arsyen se nga verifikimet e kryera rezultoi se keni një masë disiplinore në fuqi, sipas urdhrit nr. 260 datë 05.05.2020, kusht dhe kriter për lëvizjen paralele në shërbimin civil”.*

Në vijim, nëpërmjet shkresës datë 13.07.2021, “*Ankim mbi fazën e verifikimit paraprak për procedurën e lëvizjes paralele dhe për pranim në shërbimin civil, për kategorinë*

ekzekutive”, ankuesi ******, ka parashtruar pretendimet e tij se urdhri nr. 260, datë 05.05.2020, “Për dhënien e masës Disiplinore Vërejtje”, të Kryetarit të Bashkisë Berat, është i pa bazuar në prova dhe fakte dhe ka kërkuar kualifikimin në fazën e mëtejshme të konkurrimit për pozicionin e punës “Specialist Projektsh dhe Rregjistrir Elektronik”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat.

Për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve sa më sipër, u bazuanë dokumentacionin i mëposhtëm:

- Akti i emërimit nr. 5905/1 prot., datë 27.09.2018, “Urdhër nr. 786 datë 27.09.2018, Për emërim nëpunësi në shërbimin civil”, i Kryetarit të Bashkisë Berat; Akti 69 prot., datë 07.01.2021, “Konfirmim statusit të punësimit”, të Kryetarit të Bashkisë Berat; Vlerësimin e punës për nëpunësin civil në periudhë prove ***** në nivelin 3, “Kënaqshëm”; Akti nr. 275/4 prot., datë 18.02.2021, “Për lirim nga shërbimi civil”, për shkak ristrukturimi të Kryetarit të Bashkisë Berat; Urdhri nr. 107, datë 18.02.2021, “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare për nëpunësin *****”, të Kryetarit të Bashkisë Berat; Akti nr. 2502 prot., datë 05.05.2020, “Propozim për masë disiplinore”, të Drejtorit të komanduar *****; Urdhrin nr. 260, datë 05.05.2020 “Për dhënien e masës Disiplinore “Vërejtje””, të Kryetarit të Bashkisë Berat; Vendimi nr. 86, datë 26.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të cilin është vendosur “Konstatimin e diskriminimit të shtetasit Genis Gishti gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore”; aktin e datës 09.07.2021 “Njoftim i kërkesë padisë dhe akteve shoqëruese të saj”, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku ankuesi në fjalë është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, me anë të cilës kundërshton aktin administrativ, Vendimin nr. 86, datë 26.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kërkon Ndryshimin pjesërisht të këtij vendimi, në pikën dy të pjesës urdhëruese “Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit *****”, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së përfundimit të marrëdhënieve të punës në shërbim civil”, si dhe aktiv e datës 21.07.2021 “Njoftim i kërkesë padisë dhe akteve shoqëruese të saj”, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me anë të cilës Bashkia Berat, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, me anë të cilës kërkon, “Ndryshimin dhe anulimin e e pikës 1, të Vendimit nr. 86, datë 26.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si të pa ligjshëm, të pabazuar në prova, si dhe lënien në fuqi të pjesës tjetër të këtij vendimi”.

Nga shqyrtimi dokumentacionit të lartpërmendur konstatohet se:

Gjatë periudhës që, siç u tha më lart, konkurenti ******, ka qenë nëpunës civil, i konfirmuar në pozicionin “Specialist i Kontrollit të Investimeve të Punëve Publike dhe Private”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në Bashkinë Berat, ndaj tij eprori direkt ka marrë masën disiplinore “Vërejtje”, komunikuar me urdhrin nr. 260, datë 05.05.2020 të Kryetarit të Bashkisë Berat.

Pas njohjes me këtë masë disiplinore, me aktin nr. 2002/2, datë 06.05.2020, “*Kërkesë për rishikimin e masës disiplinore*”, ankuesi ka kundërshtuar duke depozituar disa observacione me shkrim, për të cilat nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Bashkia Berat.

Meqënëse nuk ka marrë përgjigje në lidhje me kundërshtimin e tij për masën disiplinore, nëpunësi ngre pretendimin që, bazuar në nenin 97/1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, mospranimi i tij është miratuar **në heshtje**, gjë e cila do të thotë se masa disiplinore ka rënë.

Meqënëse institucioni i bashkisë nuk e ka pranuar arsyetimin e mësipërm, nëpunësi i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke besuar se urdhri nr. 260, datë 05.05.2020, “*Për dhënien e masës Disiplinore Vërejtje*”, të Kryetarit të Bashkisë Berat, dhe qëndrimi i përgjithshëm i tij është diskriminues, për shkak të bindjeve politike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për hetimin administrativ, rezulton se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi ka marrë në shqyrtim ankesën nr. 144, datë 01.12.2020, të paraqitur nga nëpunësi ******, me anë të cilës pretendon se zv/Kryetari dhe Kryetari i Bashkisë Berat e kanë diskriminuar këtë nëpunës për shkak të bindjeve të tij politike, me vendimin nr. 86, datë 26.05.2021, në mënyrë të shprehur ka vendosur:

1. “*Konstatimin e diskriminimit të shtetasit ******, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, z. Ervin Demo dhe të Drejtorit të Komanduar të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, ******, për shak të bindjes politike gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, trajtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimin e statusit të nëpunësit civil*”.

Vendimi i mësipërm i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk është zbatuar nga institucioni, pasi Bashkia Berat e ka ankimuar atë në rrugë gjyqësore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, vërtetuar kjo me aktin e datës 21.07.2021 “*Njoftim i kërkesë padisë dhe akteve shoqëruese të saj*”, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me anë të cilës Bashkia Berat kërkon “*Ndryshimin dhe anulimin e pikës 1, të Vendimit nr. 86, datë 26.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si të pa ligjshëm, të pabazuar në prova dhe lënien në fuqi të pjesës tjetër të këtij vendimi*”, proces i cili nuk ka përfunduar akoma.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, njësia përgjegjëse, në momentin e kryerjes së procesit të paraseleksionimit në procedurën për lëvizje paralele në pozicionin “*Specialist Projektesh dhe Rregjistrat Elektronik*”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat, ka vlerësuar se urdhri nr. 260, datë 05.05.2020, “*Për dhënien e masës disiplinore Vërejtje*”, për sa kohë nuk është anuluar nga vetë organi publik,

një organ epror, apo nga një gjykatë, është ende në fuqi dhe për këtë arsye, është bërë pengesë për kualifikimin e aplikantit *****, në konkurrimin në fjalë.

Duke mos qenë dakort me arsyetimin e mësipërm të njësisë përgjegjëse, konkurenti nëpërmjet një kërkesë, me objekt *“Kërkesë për konstatimin absolutisht të pavlefshëm”*, në datën 27.07.2021, i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë Berat dhe ka kërkuar anulimin e urdhrin për dhënien e masës disiplinore, për shkak të pavlefshmërisë absolute.

Në përgjigje të këtij pretendimi, me shkresën nr. 3710/1 prot., datë 21.07.2021, *“Kthim përgjigje”*, Kryetari i Bashkisë Berat, ka sqaruar se në kuptim të nenit 61, pika 1/a dhe pika 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, shuarja e masës disiplinore vjen pas kalimit të afatit 2 vjeçar, nga data e njoftimit të masës disiplinore *“Vërejtje”*, duke u pasqyruar në dosjen e personelit dhe në regjistrin përkatës. Pra, për sa kohë shprehet ai, që nuk ka një akt administrativ apo një vendim gjyqësor, që të shfuqizojë urdhrin nr. 260, datë 05.05.2020, *“Për dhënien e masës disiplinore Vërejtje”*, të Kryetarit të Bashkisë Berat, vendimi për dhënien e masës disiplinore mbetet në fuqi, gjë e cila nënkupton që veprimi i njësisë përgjegjëse për skualifikimin e tij nga konkurrimi është i drejtë.

Më tej, ai vazhdon duke nënvizuar se arsyetimi i mësipërm bazohet edhe në nenin 104, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, ku parashikohet se *“Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ”*, pika 4 e tij, *“Një akt administrativ sjell si pasoja juridike: a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore, administrative ose gjyqësore; b) Për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij, ose c) Për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji”*.

Ndërkaq, gjatë hetimit administrativ u konstatua se për sqarimin e problemeve të mësipërme, nëpunësi *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, vërtetuar kjo me aktin e datës 09.07.2021 *“Njoftim i kërkesë padisë dhe akteve shoqëruese të saj”*, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me anë të cilës kërkon *“Ndryshimin pjesërisht të Vendimit nr. 86, datë 26.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në pikën dy (2) të pjesës urdhëruese, ku citohet shprehimisht: “Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit *****, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së përfundimit të marrëdhieve të punës në shërbim civil”(për shkak të shkurtimit të vendit të punës si pasojë e ristrukturimit).*

Nisur nga gjithë sa më sipër, për sa kohë asnjë organ publik apo organ gjyqësor nuk është shprehur për anulimin/shfuqizimin e urdhrin nr. 260, datë 05.05.2020 *“Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”*, të Kryetarit të Bashkisë Berat, njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me ligjin kur ka vendosur skualifikimin e konkurrentit *****, nga konkurrimi për pozicionin *“Specialist Projektsh dhe Rregjistrin Elektronik”*, në Drejtorinë

e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat. Ndërsa për ligjshmërinë e vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Disikriminimi, do të vendosë gjykata administrative, e cila do të shprehet edhe për zgjidhjen e pasojave.

Për këto arsye:

Bazuar në pikën 2, të nenit 90, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika “6”, të Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me kryerjen e procedurës për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Specialist Projektesh dhe Rregjistrat Elektronik”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në Bashkinë Berat dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Berat dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha